


**Bilanci i Rimëkëmbjes
10 masa për 8 muaj**

Hyrje

INDEP ka monitoruar për tetë muaj me radhë zbatimin e Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike përmes platformës së monitorimit të zbatimit të këtij ligji. Gjatë këtyre muajve janë monitoruar dhjetë masat e përcaktuara përmes këtij ligji. Këto masa janë miratuar me qëllim të rimëkëmbjes së ekonomisë e cila u dëmtua për shkak të pandemisë COVID-19.

Informatat e nxjerra nga ky proces monitorimi, janë paraqitur në baza mujore përmes Buletineve dhe Raporteve të monitorimit. Këto informata publikohen në mënyrë që çdo herë e më shumë publiku i gjerë të jetë i informuar rreth zbatimit të këtij Ligji, sidhe të jetë i informuar rreth mundësive që këto masa të ndihmojnë në rimëkëmbjen e sektorëve të përfshirë në Paket të cilat janë të miratuara në bazë të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike.

Përmes Buletinit të dhjetë, janë paraqitur të dhënat rreth shkallës së zbatimit të dhjetë masave të përcaktuara përmes Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike. Këto të dhëna kanë pasqyruar gjendjen e zbatimit të këtyre masave duke pasur parasysh se jemi në përfundim të tetë mujorit që nga miratimi i këtij ligji në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ndër këto masa, vlenë të theksohet se jo të gjitha kanë gjetur zbatim të duhur dhe se pritet që të vihen në zbatim të tërësishëm gjatë muajve tjerë të mbetur, përmes pakove tjera, periudhë kjo e cila pritet të jetë vendimtare për rimëkëmbjen e ekonomisë së vendit.



Masa 1

Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 05/L – 057 për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore.


Kosovar për Garanci Kreditore. Ndikimi i kësaj mase të ndërmarrë nga Qeveria e Kosovës për rimëkëmbjen ekonomike është vërejtur që në muajt e parë (dhjetor 2020 – janar 2021). Vetëm gjatë këtyre muajve krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është dalluar një rritje prej 40% të fluksit të aplikimeve për kredi. Kjo masë ka gjetur zbatim të lartë në praktikë duke ndihmuar në këtë mënyrë bizneset në rrugën e tyre drejt rimëkëmbjes ekonomike.

Masa 1 - Zbatimi i FK GK

Zbatuar

Ende ne zbatim

Pa zbatim



Masa 2

Plotësimi dhe Ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L – 101 për Fondet Pensionale të Kosovës, i plotësuar dh endryshuar me Ligjin Nr. 04/L – 115, me Ligjin 04/L – 168 dhe Ligjin Nr. 05/L-116

Pagesa e kursimeve individuale pensionale për rimëkëmbje ekonomike


Mundësia që u ofrua qytetarëve të Kosovës për tërheqjen e 10% të kursimeve të tyre nga Fondi i Kursimeve Pensionale ishte masa gjeti zbatim në praktikë. Përmes kësaj mase, qytetarët patën mundësi të tërheqnin shumën e tyre pa u tatuar dhe gjithë kjo me qëllim rimëkëmbjen e vendit. Prej gjithsej 644582 aplikuesve të mundshëm, 427363 ishe numri i aplikuesve të cilët e shfrytëzuan të drejtën e tyre për tërheqjen e kësaj shume. Prandaj mund te themi se kjo masë gjeti zbatim të lartë në periudhën kur e gjithë vendi ishte në gjendje pandemie.

Masa 2 - Zbatimi i TRUST-it

Zbatuar

Ende ne zbatim

Pa zbatim



Masa 3

Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar


Ulja e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar për furnizimin e hoteleve, restoranteve dhe shërbimeve të ushqimit ishte e mirëpritur nga ana e sektorit të gastronomisë. Kjo ulje ishte nga 18% sa ishte vlera e TVSH-së në 8% për deri në fund të vitit 2021. Kjo masë ka filluar zbatimin qysh me miratimin e ligjit dhe se pritet që të zbatohet tërësisht. Kjo pasiqë sektori i gastronomisë është cilësuar si njëri nga sektorët më të dëmtuar gjatë pandemisë COVID-19.

Masa 3 - Ulja e TVSH-së

Zbatuar

Ende ne zbatim

Pa zbatim



Masa 4

Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-102, me Ligjin 04/L-115 dhe me


Përmes këtij neni është paraparë që të lirohen nga interesi të gjithë tatimpaguesit të cilët kanë obligime tatimore të papaguara që kanë ndodhur prej datës 01.01.2020 nëse i paguajnë këto obligime deri më datën 31.12.2020. Mirëpo, duke pasur parasysh se ky ligj u miratua qysh në mes të muajit dhjetor 2020, kjo masë ka metur tërësisht e pazabatur. Kjo ka ndikuar në mos mundësinë e shfrytëzimit të kësaj mase nga ana e qytetarëve të Kosovës.

Masa 4 - ATK

Zbatuar

Ende ne zbatim

Pa zbatim



Masa 5

Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-115, me Ligjin 05/L-080 dhe me Ligjin Nr. 06/L-023


Kjo masë ka paraparë ndryshimet që ndodhin në Agjencinë Kosovare të Privatizimit me qëllim të rimëkëmbjes ekonomike. Kjo pasiqë këto fonde do përdoren për investime që do ndihmojnë në ngritjen e ekonomisë së vendit dhe kështu do ndihmojnë drejtpërdrejtë rimëkëmbjen ekonomike. Kjo masë ende nuk ka gjetur zbatim të tërësishëm, por që pritet se zbatimi i saj do jetë më i madh deri në fund të vitit, kur edhe pritet edhe miratimi i pakove të reja të cilat kanë për qëllim kryesor rimëkëmbjen ekonomike të vendit si pasojë e pandemisë

Masa 5 - AKP

Zbatuar

Ende ne zbatim

Pa zbatim




Masa 6

Përkrahja e ndërmarrjeve private

Masa e cila si qëllim ka përkrahjen e ndërmarrjeve private përmes shumës prej 200 milion euro ka filluar zbatim. Kjo masë ka paraparë që të gjitha bizneset të cilat kanë qenë të mbylluar ose që kanë pasur probleme të funksionimit të rregullt gjatë pandemisë dhe që janë të regjistruar në Administratën Tatimore të Kosovës do ndihmohen përmes kësaj shume. Zbatimi i saj ka filluar shumë vonë, dhe se po pritet që të zbatohet tërësisht deri në fund të vitit. Kjo masë është më se e nevojshme, duke parë se sektori privat është direkt i involvuar në ekonominë e vendit.

Masa 6 - Përkrahja e ndërmarrjeve private


Zbatuar**Ende ne zbatim****Pa zbatim**

Masa 7

Pagat e punëtorëve në sektorin privat

Përmes Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike është paraparë edhe pagesa e pagave të punëtorëve të cilët janë pezulluar nga puna ose janë larguar si shkak i pandemisë. Kjo masë është paraparë që të mbulojë shumat prej 300 eurove për 3 muaj, për të gjithë këta punëtorë. Mirëpo, zbatimi i kësaj masë ka qenë i papërfillshëm dhe nuk ka filluar edhe pas një viti pandemie. Kjo pasiqë këto pagesa janë menduar të shpërndahen gjatë vitit të kaluar, duke rënë kështu ndesh me kohën kur ky ligj është miratuar.

Masa 7 - pagesa e punëtorëve në sektorin privat


Zbatuar**Ende në zbatim****Pa zbatim**

Masa 8

Përparësitë për prodhuesit e produkteve dhe shërbimeve vendore përgjatë pandemisë COVID-19

Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike ka paraparë edhe se gjatë vlerësimit të ofertave që dorëzohen nga prodhuesit vendorë dhe shërbimeve vendore, të u jepet përparësi në mënyrë që të u ndihmohet me qëllim të rimëkëmbjes së tyre. Edhe pse si masë e rregulluar përmes nenit 13 të këtij ligji, zbatimi i tij mbetet shumë i pakët, e mos të themi aspak i knaqshëm. Kjo masë pritet që të gjejë zbatim më të lartë në muajt në vijim.

Masa 8 - Përparësitë e prodhuesve vendorë


Zbatuar**Ende ne zbatim****Pa zbatim**

Masa 9

Plotësimi dhe Ndryshimi i Ligjit Nr. 03/L-163 për Minerat dhe Mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158

Lirimi nga pagesa e rentës minerare e të gjitha subjekteve të cilat janë të obliguara të paguajnë këtë tariffë, ishte masa tjetër e përfshirë në Ligjin për Rimëkëmbje Ekonomike. Kjo masë edhe pse e zbatuar tërësisht gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti, nuk është paraparë se do ndihmojë direkt në rimëkëmbjen ekonomike. Kjo pasiqë përmes kësaj mase ndihmën më të madhe e kanë marrë dy ndërmarrje kryesore të cilat pandemia nuk ka ndikuar direkt në to.

Masa 9 - Renta minerare


Zbatuar**Ende ne zbatim****Pa zbatim**

Masa 10

Plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë

Subvencionimi i tarifave të energjisë së marrur nga Burimet e Ripërtrishme të Energjisë Elektike e përvaktuar përmes nenit 15 të Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike ka gjetur zbatim të pjesshëm në praktikë. Kjo pasiqë përmes këtij ligji ishte paraparë që ky subvencionim të ishte pesë muaj duke filluar nga janari 2021 deri në muajin maj 2021. Mirëpo, Qeveria e Kosovës ka ndarë për këtë masë vetëm tetë milion euro, mjete këto të pamjafuteshme sipas KOSTT. Prandaj ky subvencionim u përmbush vetëm në tre muajt e parë të vitit 2021.

Masa 10 - Subvencionimi i BRE-ve

Zbatuar**Ende në zbatim****Pa zbatim**

10

BULETINI I RIMËKËMBJES

korrik 2021



Ky buletin është përgatitur me mbështetjen e Fondacionit të Kosovës për shoqëri të Hapur (KFOS). Pikëpamjet e shprehura në këtë buletin janë INDEP dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohen si qëndrim i Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të hapur (KFOS).